



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.207/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të vendosjes së posterit në objektin publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, Anr.207/2019 të datës 03.10.2019, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – sepse se me datën 03.10.2019, rreth orës 15:01, në Fushë Kosovë afër shkollës fillore “Mihail Grameno”, mbi rrugë publike në mbikalim është i vendosur një poster i kandidatit për kryeministër dhe kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK), i **SHQIPTOHET** gjobë në vlerë prej 6,100.00€ (gjashtë mijë e njëqind euro,) të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me të cilën pretendon se me datën 03.10.2019, rreth orës 15:01, në Fushë Kosovë afër shkollës fillore “Mihail Grameno”, është parë i vendosur një poster i madh i kandidatit për kryeministër dhe kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK). Parashtuesi i ankesës me tutje thekson se vendosja e posterëve në afërsi të shkollave dhe institucioneve publike është e ndaluar me ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, perkatësisht nenin 33 pika b, me rregulloret 13/2013, neni 3 pika 3.4 dhe Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike neni 4 pika b, si provë për pretendimet e tyre paraqitësi ka bashkangjitur një (2) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019 subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), theksohet se ankesa në fjale duhet të hudhet si e pabazuar për faktin se nga PZAP, objekti i kësaj ankese ka qene edhe me herët i shqyrtuar dhe vendosur me rastin Anr 89/2019

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për kryeministër nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është ngjitur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “

*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për kryeministër dhe kandidatit për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është vendosur në objektin publik përkatësisht mbi rrugë publike. Të cilën shkelje nuk e ka pranuar subjekti politik Partia Demokratike, në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik, në fjalë, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë mbi rrugë publike që nuk është vend i dedikuar për vendosjen e materialit të zgjedhjeve gjatë fushatës zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politikë në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirëson shkeljen e bërë. Mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë thekson se ky rast ka qenë objekt shqyrtimi me vendimin Anr 89/2019. Paneli gjeti se nuk qëndrojnë këto konstatime të subjektit politik PDK, pasi që me rastin Anr 89/2019, objekt shqyrtimi ka qenë posteri i vendosur në bilbord ndërsa për ankesën Anr 207/2019 behet fjale për banerin e vendosur mbi rrugë publike në mbikalim të kandidatit për kryeministër dhe kandidatit për deputet nga radhet e subjektit politik PDK. Andaj nga këtu shihet qartë se subjekti politik PDK nuk e kanë pranuar shkeljen dhe nuk kanë ofruar asnjë dëshmi lidhur me atë se është bërë përmirësimi i shkeljes siç kërkohet me nenin 120 par. 1 pika a) të LPZ-së, të gjitha këto veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 207/2019 më datën 05.10.2019

Kryesuesi i Panelit  
Adnan Konushevoi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi